



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:264405

Datë: 19.09.2024

Numri i dokumentit: 06179252

**C.nr.848/2023**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI**, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtoreshen profesionale Lumturije Fetahu Xhelili, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.G.nga Vitia, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.M., avokat në Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Vitisë-Drejtoria e Shëndetësisë, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13 (trembëdhjetë), me vlerë të kontestit 2,645.80 €, jashtë seancës, me datë 18.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. Refuzohet** në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses M.G.nga Vitia, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Vitisë-Drejtoria e Shëndetësisë, që për fund vitin 2020, 2021, 2022 dhe 2023, t'ia kompensojë pagën e 13 (trembëdhjetë), duke llogaritur nga 661.45 € për secilin vit, në shumën 2,648.80 €, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë, në afat prej 7 ditëve pas pranimit të aktgjykimit, nën pasojat e përbarimit ligjor.

**II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, me datë 07.12.2023, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13 (trembëdhjetë), me vlerë të kontestit 2,645.80 €.

Paditësja, në padi dhe precizimin e kërkesëpadisë së datës 12.09.2024, ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura në QKMF "Nëna Terezë", në pozitën e infermieres-mami. Bazën ligjore të kërkesëpadisë e ka mbështetur në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale (tutje KKS), përkatësisht në nenin 17, par. 2, 3, nën par. 3.2 dhe nenin 35, par. 8 të saj, të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur asnjëherë ndaj punëtorëve të shëndetësisë andaj, gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, ashtu që të detyrohet e paditura, që për fund vitin 2020, 2021, 2022 dhe 2023, t'ia kompensojë pagën e 13 (trembëdhjetë), duke llogaritur nga 661.45 € për secilin vit, në shumën 2,645.80 €. Si prova ja ka bashkëngjitur padisë: Vërtetimi nr. 372 dt 20.11.2023, Kontrata e punës nr. 079. Lista e pagave. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, shumën 122.72€ për përpilimin e padisë dhe shumën 30 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar se kërkesës i mungon baza ligjore pasi sipas Ligjit mbi Financat Publike, pagat paguhet nga niveli qendror, përkatësisht Ministria e Financave dhe ajo e Shëndetësisë si palë nënshkruese të Kontratës në të cilën është thirrur paditësja. Tutje

ka shtuar se Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se KKS është lidhur për një afat 3 vjeçar edhe atë nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021, andaj kërkesa e paditëses për kompensim për vitin 2021 dhe 2022 ka skaduar.

Për më tepër, ka theksuar se e paditura si institucion shëndetësor mund t'i kompensojë punëmarrësit për pagën e 13 vetëm sipas mundësive buxhetore, bazuar këtë edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës. E paditura, duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës është thirrë edhe në parashkrim të kërkesëspadisë së paditëses andaj si përfundim, gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e saj të pa bazuar. Buxheti i apotvuarm alokuar dhe shpenzimet për të gjitha programet buxhetore Janar –Dhjetor 2020, dhe Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore dhe Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore, bazuar në nenin 399, par. 1 dhe 2 të LPK-së, në të cilën është përcaktuar se: “Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigjja në padi konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pa themeltë, në vështrim të paragrafit 1 të kësaj neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësja apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, gjykata ka gjetur se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar tek e paditura (provë: kontrata e punës nr. 079, dhe vërtetimi 372 dt 20.11.2023, lëshuar nga QKMF “Nënë Tereza”) dhe se paga bazë e saj është 871.32 € (provë: lista e pagës).

Në KKS të Shëndetësisë të datës 11.06.2018, në nenin 17, par. 2 është përcaktuar se: “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”.

Zbatimi i KKS-së, aplikohet për periudhën 11.06.2018-10.06.2021, ndërsa mos realizimi i pagës së 13 justifikohet vetëm nëse punëdhënësi provon se në asnjë mënyrë nuk ka pasur mundësi buxhetore për të kompensuar këtë pagë. Ky interpretim është në harmoni edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 40/2023, të datës 27.02.2023 dhe nr.212/2023, të datës 09.10.2023.

Gjykata, për të provuar mundësitë buxhetore të të paditurës, si provë ka administruar Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (tutje SHSKUK) për vitin 2020, i publikuar në Korrik të vitit 2021 në Prishtinë, nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Në faqen 23 dhe pikën 3 të këtij raporti, është konstatuar se “në vitin 2020, SHSKUK ka shpenzuar 95 % të buxhetit përfundimtar ose 126,021.739 €, me një ulje 4% në krahasim me vitin 2019”. Në ekstraktin tabelar shihet se në vitin 2020 për kategorinë pagat dhe mëditjet, buxheti final ka qenë 76,308,249.55 €, ndërsa shpenzimet kanë qenë 76,249.758,81 €. Nga kjo konstatohet se 58,490.74 € për vitin 2020 nuk është shfrytëzuar buxheti final nga e paditura sa i përket kategorisë pagat dhe mëditjet. Mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, gjykata ia fali besimin e plotë kësaj prove pasi vlerësoi se Raporti i Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka fuqinë provuese të saktësisë së të dhënave në të.

Gjykata vlerëson se kjo shumë nuk paraqet mundësi buxhetore të mjaftueshme për kompensimin e pagës së 13 pasi përbën një shumë që nuk mundet të përfshijë/kompensojë të gjithë punëmarrësit, me ç'rast provon se e paditura nuk ka mundësi buxhetore për këtë

kompensim apo thënë ndryshe, suficiti prej 58,490.74 € nuk paraqet mundësi buxhetore mbi bazën e së cilës mund të kompensohen të gjithë punëmarrësit për pagën e 13.

Gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar padinë e paditësit si të pabazuar ngase paditësja nuk kanë arritur të dëshmojnë me prova konkrete se ju takon një kompensim i tillë, për më tepër se e paditura ka mundësi buxhetore për realizimin e të ardhurave nga paga e 13 (trembëdhjetë) ashtu siq edhe parashihet me dispozitat ligjore të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, saktësisht me nenin 43 par.6 si dhe me Kontratën Kolektive Sektoriale Nr.05-3815 në nenin 17 par.2, në të cilat decidivisht parashihet se punëtorër mund të kompensohen me pagën e trembëdhjetë (13) në bazë të mjeteve mundësive buxhetore, e që në asnjë rrethanë në rastin konkret fjala “mund” nuk është obligative se paditësit ju takon kompensimi i tillë, e për më tepër e njëjta është e lidhur ngusht me mjetet buxhetore të paditurës, e në rastin konkret nuk është dëshmuar me asnjë provë nga ana e palës paditëse se është plotësuar një kusht i tillë, i cili edhe sikur të plotësohej përsëri do të ishte në vullnetin e palës së paditurë pagesa e pagës së 13 (trembëdhjetë), meqenëse edhe dispozitat ligjore të lartëtheksuara nuk e obligojnë decidivisht të paditurën për realizimin e pagës së 13 mirëpo të njëjtën e kanë lënë si mundësi në raport me mundësitë materiale

Meqenëse e paditura është thirrë në parashkrim të kërkesës së paditëses, gjykata, lidhur me kërkesën për kompensimin e pagës së 13, shqyrtoi dokumentet përkatëse vetëm sa i përket vitit 2020 pasi gjeti se meqë paditësja ka ushtruar padi me datë 07.10.2023, kërkesa për kompensim për vitin 2020 është parashkruar, bazuar kjo në nenin 87 të Ligjit të Punës ku është paraparë se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës” ndërsa, sa i përket kërkesës për fund vitin 2021, 2022, dhe 2023 kërkesa është e skaduar pasi KKS ka qenë në fuqi vetëm deri me datë 10.06.2021. Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore të nenit 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit të të paditurës në këtë procedurë, ajo nuk ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Nga të lartcekurat dhe duke u mbështetur në nenin 143, par. 1 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA VITI**  
**C.nr.848/2023, Datë 18.09.2024**

**G j y q t a r i**  
Raif Fazliu

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.